

VENDIM
Nr. 63/2024

PËR RRËZIMIN E LISTËS SË DYTË NË BLOK TË KANDIDATËVE
TË PËRZGJEDHUR PËR ANËTARË TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
NGA RADHËT E AVOKATËVE, SIPAS LIGJIT NR. 115/2016,
“PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË”,
I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 147, pika 8, të Kushtetutës; të nenit 35, pika 16, të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e listës së dytë në blok të kandidatëve për anëtarë nga radhët e avokatëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që kanë rezultuar nga hedhja e shortit në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:

1. Erind Mërkuri
2. Albens Tabaku

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 4.7.2024.